

Formularin e plotësuar, mund ta dërgoni pranë Zyrës së Komisionerit në adresën e-mail info@idp.al, dorazi ose nëpërmjet postës në adresën: Rr. Abdi Toptani, Tiranë,

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Neni 24

Procedurat për shqyrtimin e ankesave

- 1.** Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.
- 2.** Ankimi administrativ pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:
 - a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
 - b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.
- 3.** Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe Autoritetit Publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.
- 4.** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.
- 5.** Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos:
 - a) mospranimin e ankesës kur:
 - i) ka kaluar afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni;
 - ii) ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;
 - iii) nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit;
 - b) pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme;
 - c) rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht;
 - ç) afatin, brenda të cilit Autoriteti Publik duhet të zbatojë urdhrin.
- 6.** Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t’iu drejtuar gjykatës.
- 7.** Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk çënon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr. 8454, datë 04/02/1999, “Për Avokatin e Popullit”.